



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

---

Nr. 419/12 Prot.

Tiranë, më 28/12/2016

**V E N D I M**  
**Nr. 168, Datë 28/12/2016**

**PËR**  
**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË**  
**PERFORMANCËS, “MENAXHIMI I MBETJEVE URBANE NË BASHKINË**  
**E TIRANËS”**

Në zbatim të planit vjetor 2016, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas programit të miratuar të auditimit, ndërmori auditimin e performancës me temë: **“Menaxhimi i Mbetjeve Urbane në Bashkinë e Tiranës”**.

Ky auditim u programua për t’u ushtruar në subjektet: Bashkia e Tiranës (Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike; Drejtoria e Politikave dhe Edukimit Mjedisor), duke u shtrirë edhe në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe të Aseteve, Drejtorinë e Kabinetit të BT, në Drejtorinë e Përgjithshme të Punëtorëve nr. 1 të qytetit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Rajonale të Mjedisit për Tiranën, etj.

Në aparatën e Bashkisë së Tiranës, Drejtoria e Pastrimit të Mbetjeve Urbane, përmbush detyrat që lidhen me menaxhimin dhe financimin e të gjitha kontratave përfshirë raportimin periodik, teknik dhe financiar mbi ecurinë e realizimit të tyre; mban përgjegjësi për kontrollin e situacioneve dhe dokumentacionit të përgatitur për financim; monitoron realizimin e cilësisë së shërbimit për të gjitha kontratat bazuar në kushtet e kontratës; verifikon e kontrollon punën e kontraktorëve dhe realizon bashkëpunim të qëndrueshëm me ta; propozon standarde dhe specifikime teknike dhe vlerëson situatën në bazë të informacioneve që disponon për menaxhimin e aktivitetit të pastrimit të qytetit, duke sugjeruar dhe marrë vendimet më efektive; ndjek dhe evidenton treguesit tekniko-ekonomikë të operatorëve të shërbimit të kontraktuar për pastrimin e qytetit, analizimin e tyre dhe ndërhyrjen në rastet e duhura për përmirësimin e tyre; përgatit plane veprimi për trajtimin e mbetjeve urbane dhe të ngurta në zbatim të Strategjisë dhe planit kombëtar për menaxhimin e mbetjeve; identifikon dhe analizon problemet e hasura në trajtimin e mbetjeve duke sugjeruar rrugët e zgjidhjes së bashku me kostot e nevojshme për zbatimin e tyre; bashkëpunon ngushtësisht me struktura të tjera politikë-bërëse për zgjidhjen e problematikave të ndryshme në funksion të përmirësimit të punës së sektorit; grumbullon, përpunon dhe përgatit të dhëna periodike mbi vend depozitimin

e mbetjeve në Sharrë, me qëllim administrimin e trajtimin e mbetjeve urbane sipas standardeve bashkëkohore; etj.

Drejtoria e Politikave të Edukimit Mjedisor ka si detyrë hartimin e planeve, monitorimin dhe edukimin për mbrojtjen e mjedisit urban, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës së banorëve, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit të Tiranës dhe territoreve përreth. Përcakton prioritetet e qytetit në fushën mjedisore dhe ndërhyrjet konkrete për realizimin e tyre si dhe orientimin, administrimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së mjedisit në qytetin e Tiranës.

Skema e pastrimit e ndan qytetin në 6 (gjashtë) zona operative dhe pastrimi i qytetit të Tiranës sot realizohet nga gjashtë operatorë privatë me të cilët Bashkia e Tiranës ka lidhur kontrata të veçanta, të cilat i depozitojnë mbetjet në landfillin e Sharrës. Landfill-i i Sharrës administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit të Tiranës, e cila ka për detyrë pastrimin dhe gjelbërimin e territorit. Ky landfill pozicionohet rreth 7 km në jug-perëndim të qendrës së Tiranës dhe ndodhet rreth 400-500 m në jug-perëndim të fshatit të Sharrës.

Nëpërmjet auditimit të performancës mbi menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë e Tiranës, duke u përqendruar te efektiviteti dhe efienca e punës së operatorëve ekonomikë në shërbimin e pastrimit dhe të grumbullimit të mbetjeve urbane, bëhet një analizë studimore mbi gjendjen aktuale në territorin e bashkisë, zbatimin e detyrimeve kontraktore nga operatorët ekonomikë, rolin e strukturave përgjegjëse të bashkisë dhe mundësitë e pashfrytëzuara për një menaxhim më të mirë të këtij problemi madhor mjedisor jo vetëm në Tiranë, por në të gjithë vendin duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes dhe rritur vetëdijen e strukturave drejtuese e zbatuese të Bashkisë Tiranë dhe publikut të gjerë për këtë problem thelbësor të shoqërisë sonë.

Në të njëjtën kohë, është audituar lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore nga të gjitha institucionet që ndjekin këtë problematikë, me objektiv rritjen në vazhdimësi të transparencës dhe efektivitetit në menaxhimin e mbetjeve urbane në territorin e bashkisë Tiranë.

Përveç kërkesave të Rregullores, Manualit të Auditimit të Performancës së KLSH-së, Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit - ISSAI, janë kërkuar dhe shfrytëzuar materiale të ndryshme: Plane strategjike dhe studime përkatëse të subjekteve ku është shtrire auditimi, artikuj të medias së shkruar, konkluzione të informacioneve që lidhen me problemin e menaxhimit të mbetjeve, direktiva dhe raporte të organizatave ndërkombëtarëve, etj.

Duke qenë se menaxhimi i mbetjeve është një problem serioz dhe emergjent në të gjithë vendin që ka rrjedhur nga moszbatimi i Strategjive, Kuadrit rregullator dhe akteve ligjore e nënligjore të miratuara si nga organet e pushtetit vendor dhe atij qendror theksojmë se rezultatet e këtij auditimi i kalojnë caqet e Bashkisë së Tiranës, janë përgjithësuese e të vlefshme edhe për njësitë e qeverisjes vendore e qendrore.

Pas përfundimit të punës paraprake audituese, me shkresën nr. 419/3, datë 02.09.2016 u dërgua Programi i Auditimit të Performancës. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr. 419/9, datë 24.11.2016 iu dërgua Projekt-Raporti i auditimit subjekteve të audituara. Raporti përfundimtar është hartuar pasi janë shqyrtuar komentet dhe shpjegimet e

dërguara nga Bashkia e Tiranës me shkresën nr. 36371/1 prot. datë 21.12.2016, si dhe pas konsultimeve me palët e interesit.

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

## K O N K L U D O V A:

### Për Bashkinë e Tiranës

**(Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike; Drejtoria e Politikave dhe Edukimit Mjedisor, Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Aseteve, Drejtoria e Kabinetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Puntorëve nr. 1 të qytetit):**

Gjendja e menaxhimit të mbetjeve urbane dhe pastrimit të Qytetit të Tiranës, me gjithëse në zëra të caktuara ka përmirësim, lë ende shumë për të dëshiruar, më saktë nuk është e mirë dhe në parametrat që kërkohen për një kryeqytet që aspiron të jetë pjesë e familjes europiane. Edukimi publik në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit në menaxhimin e mbetjeve, nga ana e strukturave të bashkisë dhe operatorëve ekonomikë ka patur mangësi të theksuara dhe nuk ka qenë e mjaftueshme. Sjellja e vëmendjes së publikut për parandalimin dhe eliminimin e mbetjeve është hapi i parë themelor për të nxitur ndryshimin e sjelljes së popullsisë ndja këtij problem jetik.

Problemi i menaxhimit të mbetjeve, i cili është në rritje të shpejtë dhe që përbën një kërcënim për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave, mund të realizohet vetëm kur institucionet e arsimit, shoqërisë civile dhe individëve, si dhe të administratës qendrore, administratës lokale, industriale dhe qendrat tregtare janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre dhe i përmbushin ato. Kështu, në menaxhimin e mbetjeve urbane të bashkisë së Tiranës, si një organ vendor dhe më pranë komunitetit, qasja “qeverisja me pjesëmarrje” duhet të ishte gjithnjë në qendër të vëmendjes së strukturave përgjegjëse të bashkisë.

Bashkia e Tiranës nuk ka zbatuar legjislacionin për ndarjen dhe grumbullimin e mbeturinave që në burim, fakt ky që ka influencuar negativisht në gjendjen e vend-depozitimit të Sharrës si dhe mosfurnizimin me lëndë të parë të subjekteve private që merren me riciklimin e mbeturinave sipas llojit. Vlen të theksohet së ky proces nuk kryhet edhe për institucionet shtetërore në drejtim të grumbullimit të letrave, si dhe për mbetjet e rrezikshme si tonera, pajisje kompjuterike, etj.

Bashkia e Tiranës, nuk ka studim të mirëfilltë mbi prodhimin total të mbetjeve urbane në zonat për të cilat janë kontraktuar subjektet private të pastrimit, studim i cili të pasqyronte faktorët socio-ekonomikë (konsumi për familje, aktivitetet e prodhimit, etj), faktorët territorialë (karakteristikat urbanistike, popullsinë, densitetin e banimit, numrin e tipologjinë e përdoruesve

jo shtëpiakë, vëllimin e fluksit të hyrjeve në Tiranë, etj). Të gjitha këto do të çonin në identifikimin e gjenerimit të mbetjeve për frymë si dhe në identifikimin e gjenerimit total të mbetjeve urbane, sipas zonave për të cilat janë lidhur kontratat.

Bashkia e Tiranës nuk ka të evidentuar mbetjet urbane si mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetje të gjeneruara nga institucionet të ngjashme, si mbetje urbane, por që kanë veti të rrezikshme si: pesticidet, fotokimikatet, acidet, tretësit, bojëra, ngjyra, ngjitës, etj., që përmbajnë substanca të rrezikshme, detergjent që përmbajnë substanca të rrezikshme, bateritë dhe akumulatorët, pajisjet e skaduara elektrike e elektronike, mbetje të tjera që përmbajnë merkur, mbetje druri që përmbajnë substanca të rrezikshme, etj. Evidentimi i tyre nga ana e Bashkisë së Tiranës, do të bënte që këto mbetjeve t'i nënshtroheshin një trajtimi mjedisor të veçantë dhe të mos trajtohen si mbetjet urbane pa veti të rrezikshme

Në kontratat që Bashkia e Tiranës ka lidhur me subjektet e pastrimit për vite me radhë, ndër të tjera, është planifikuar edhe zëri i shërbimit “Fshirja e rrugëve dhe trotuarëve me krah” dhe “Fshirja e rrugëve dhe trotuarëve me makineri”. Në këtë zë, nuk janë të veçuara si zë më vete, fshirja e rrugëve dhe zë më vete fshirja e trotuarëve.

Nga kontrollet e grupit të auditimit, si dhe nga informacionet e komunitetit rezultuan 24 vënd-depozitime të paligjshme. Shumica e këtyre vënddepozitimeve u lokalizuan në zonat e rrethinave, veçanërisht përgjatë skarpatit të lumi Tiranë, si dhe rrjedhjen e sipërme dhe të poshtme të lumit Lana, pranë unazës së re. Në disa nga këto zona rezultonte një përzierje e të mbeturinave ndërtimore me ato familjare. Në disa raste nuk kryhet pastrimi i territorit të kontemierëve, dhe nuk kryhet dizinfektimi në mënyrë sistematike rreth vendit të kontemierëve të mbetjeve.

Problem mjaft i madh rezulton edhe nga mungesa e vendeve për vendosjen e kontemierëve në disa zona me intesitet të lartë ndërtimi si zona e Stacionit të Trenit, Rruga Don Bosko, Komuna e Parisit, Rruga e Dibrës, Zona e Pazarit të Ri, kjo për arsye të dhënies së lejeve të ndërtimit të objekteve shumëkatëshe në kundërshtim me kondicionet urbanistike të përcaktuara..

Vazhdon të mbetet problem vendosja e pikave të grumbullimit në zona me rrugica të ngushta dhe intesitet të lartë ndërtimit si: Blloku Kafodi, rrugët ndërmjet Rrugës së Kavajës dhe Rrugës Myslym Shyri, ku është e pamundur shtimi i pikave të reja dhe shpesh nga subjekte të ndryshme dhe nga qytetarë bëhet lëvizja dhe bashkimet e pikave.

Ndotja e shkaktuar si pasojë e hedhjes abuzive të mbetjeve voluminoze tregtare nga tregjet privatë apo ambulante, nga subjektet tregtare apo prodhuese, duke ndotur në mënyrë të vazhdueshme rrugët dhe sheshet publike si në rrugicat e tregut Çamëria, Pazari i ri, e gjitha tregjet e fruta perimeve.

Hedhja pa kriter e mbetjeve inerte, skeletike nga banorët e disa zonave, bizneset, firmat e ndërtimit etj.

Mbetjet shkarkohen në zonat e rrethinave të Bashkisë, veçanërisht në zonat përgjatë skarpatëve të lumit Tiranë dhe në rrjedhjet e sipërme dhe të poshtme të lumit Lana. Këto zona nuk kanë kontemierë mbetjesh ose kontemierët janë shuma larg përdoruesit. **Përsëritje**

Si venddepozitim shërben një impiant grumbullimi **mbetjesh që nuk plotëson standardet e një landfilli të mirëfilltë**, pa elementët bazë të funksionimit, si mbështjellja e faqeve anësore me pobeliten, me një sistem drenazhimi i ujrave atmosferik dhe ujit (leksiviatit) që krijohet nga hedhurinat dhe një sistem të pjesshëm për djegien e biogazit të prodhuar nga dekompozimi i mbetjeve. Kështu nisur nga rreziku i paralajmëruar mbi praninë e personave të paautorizuar, më nëntor 2015 ka ndodhur një aksident i rëndë me humbjen e jetës së një shtetaseje në orët e vona të natës, e cila gjatë punës së paautorizuar, është përplasur nga një mjeti i cili po përpunonte mbetje. Përsëri në gusht të 2016 në këtë venddepozitim ndodhi një ngjarje e rëndë që tronditi opinionin public, ku humbi jetën në mënyrë tragjike një 17-vjeçar, gjë e cila u trajtua si skandal i rëndë nga ana e medias sepse sipas saj, ishte punësuar nga Kompania “**■**” që kishte ngritur impiantin e riciklimit brenda territorit të venddepozitimit të Sharrës, ku punonte si i pasiguar. Bashkia e Tiranës si pronare e vetme e mbetjeve pezulloi punimet e më pas ndërpreu kontratën me kompaninë e riciklimit “**■**” ku ndodhi ngjarja tragjike.

Nisur nga rastet e rënda të parashtruara nga media, grupi i auditimit mbështetur në nenin 26, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën datë 30.09.2016 “Kërkesë për vënien në dispozicion dokumentacioni për grupin e auditimit të KLSH-së”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, ka kërkuar vënien në dispozicion brenda datës 04.10.2016, të *praktikës dokumentare të procedurës së zhvilluar në lidhje me dhënien për subjektin privat 3 R të drejtës së ngritjes së një linjës seleksionimi dhe përdorimit të mbetjeve të ngurta në landfillin e Sharrës që administrohet nga Bashkia Tiranë.*

Bashkia Tiranë në përgjigjen e saj me shkresën nr. 29475/1, datë 11.10.2016, vëren se është e pamundur vënia në dispozicion e këtij dokumentacioni, duke qenë se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka regjistruar një procedim penal dhe çështja në fjalë, është ende në hetim nga ana e këtij organi dhe për këtë shkak nuk mund të ndërmarrim asnjë veprim që mund të dëmtojë apo pengojë veprimet e këtij organi. Për këtë arsye grupi i auditimit nuk mund të auditonte praktikën dokumentare të kontratës së lidhur nga Bashkia e Tiranës me OE **■** sh.p.k., mbi të drejtën e ngritjes së linjës së seleksionimit dhe përdorimit të mbetjeve të ngurta në venddepozitimin e Sharrës.

Gjatë periudhës së ushtrimit të këtij auditimi, *në përputhje me memorandumin e bashkëpunimit, të nënshkruar në fund të vitit të kaluar nga kryebashkiakët e Tiranës dhe Veronës, është krijuar një ndërmarrje e përbashkët, me pjesëmarrjen edhe të sektori privat, që do të realizojë pastrimin një pjese të qytetit të Tiranës. Kompania publike “Eco Tirana” është regjistruar tashmë më 22 qershor 2016 në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ajo është një ndërmarrje me kapital të përzier, mes Bashkisë së Veronës dhe asaj të Tiranës, ku 49% të aksioneve janë në pronësi të **■** (shoqëria përfaqësuese e Bashkisë së Veronës, Itali) dhe 51% e ka në pronësi bashkia e Tiranës.*

Forma e krijimit të kësaj ndërmarrje të përbashkët dhe përmbajtja e realizimit të kontributeve pjesmarrëse janë trajtuar nga media si mungesë transparence, pa sqaruar publikun e gjerë realisht për qëllimin e kësaj shoqërie aksionere, si dhe planet disavjeçare që ka ndërmend të realizojë me këtë shoqëri, kontributi në natyrë i BT në dhënien e sipërfaqes prej 22,000m<sup>2</sup> për 25 vjet që deri tani ishte në pronësi të Bashkisë Tiranë, i jepet me qëllim ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve të shoqërisë, etj. Duke qenë se kjo kompani akoma nuk është ngritur si strukturë dhe nuk ka filluar aktivitetin për të cilën është themeluar, në një periudhë të mëvonshme është i nevojshëm ushtrimi i një auditimi

përputhshmërie, kur kompania të ketë ushtruar veprimtarinë si subjekt i menaxhimit të mbetjeve urbane pranë bashkisë Tiranë.

Nga analiza e punës së mbikqyrësve të Bashkisë së Tiranës, duke vlerësuar metodat e përdorura, rezulton se nga mbikqyrësit nuk është vlerësuar puna e operatorëve për të gjitha kriteret e kontratës, por janë marrë vetëm disa procese pune që nuk kanë peshë dhe janë të pamatshëm pas faktit. Mbikqyrësit duhet të kishin marrë parasysh edhe kriteret e tilla si psh, mbi gjendja e kazanëve të grumbullimit, dëmtimi i tyre, vendodhja dhe kushtet higjienike të tyre.

Nga Agjencia e Mbrojtjes Konsumatorit për periudhën objekt auditimi, janë vendosur gjoba, por nuk ka asnjë evidencë apo informacion, nëse këto gjoba janë arkëtuar, pra konstatohetse nuk është bërë ndjekja e arkëtimit të këtyre gjobave. Ekzekutimi i gjobave nuk është dokumentuar sipas kërkesave administrative e ligjore dhe ka munguar bashkëpunimi e koordinimi i punës me Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave Vendore(këto dy subjekte megjithë kërkesën tonë nuk kanë paraqitur dokumentacion apo informacion mbi ekzekutimin e këtyre gjobave me pretendimin se nuk kemi të dhëna....) dhe mungojnë evidencat përkatëse. Sipas dokumentacionit dhe informacionit të administruar nga grupi i auditimit, për vitet 2012 (6 mujori parë) - 2016, rezultojnë se janë vënë **233 gjoba me vlerë 1,434,000 lekë**. Këto gjoba kanë mbetur në letër dhe ka patur një ndikim negativ si tek subjektet juridike, por dhe tek njerëzit, për rritjen e përgjegjshmërisë ndaj menaxhimit të mbetjeve urbane e pastrimit të qytetit, pra të mbajtjes pastër të qytetit të Tiranës.

Bazuar në sa më sipër, KLSH është përpjekur t'i japë përgjigje pyetjes: **“A ka qenë efektiv menaxhimi e mbetjeve urbane të Bashkisë së Tiranës nga operatorët ekonomikë të kontraktuar?”**, duke konsideruar veçanërisht kuadrin rregullator e ligjor dhe detyrimet kontraktore si dhe zbatimin nga ana e strukturave përgjegjëse të Bashkisë Tiranë e operatorët ekonomikë, duke arritur përfundimisht në këtë mesazh auditimi:

Nëpërmjet kontraktimit të operatorëve ekonomikë për menaxhimin e mbetjeve urbane Bashkia e Tiranës:

1. Nuk ka arritur objektivat në drejtim të shërbimit të popullatës dhe ruajtjes së mjedisit në territorin e saj.
2. Kuadri rregullator në zbatim strategjisë kombëtare dhe akteve ligjore bashkëkohore të miratuara nuk është i përditësuar dhe si rrjedhojë objektivat nuk janë të qarta e të përcaktuara mirë.
3. Edukimi publik në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit në menaxhimin e mbetjeve, nga ana e strukturave të bashkisë dhe operatorëve ekonomikë ka patur mangësi të theksuara, nuk ka qenë i mjaftueshëm dhe nuk ka dhënë ndonjë impakt të ndjeshëm social, për mbajtjen pastër të qytetit dhe për ndarjen e mbetjeve në burim për riciklim; në menaxhimin e mbetjeve urbane të bashkisë së Tiranës, si një organ vendor dhe më pranë komunitetit, qasja “qeverisja me pjesëmarrje” duhet të ishte gjithnjë në qendër të vemendjes së strukturave përgjegjëse të bashkisë.
4. Venddepozitimi i mbetjeve në zonën e Sharrës nuk plotëson kushtet e parametrat e një landfillit bashkëkohor me parametra të lartë mjedisor sidhe ka tejkalluar afatin e përdorimit dhe kapacitetet e përpunimit.
5. Veprimtaria e mbikëqyrëse dhe kontrolluese e Bashkisë Tiranë, në drejtim të realizimit të detyrimeve kontraktore nga operatorët ekonomikë për shërbimin e grumbullimit dhe

largimit të mbetjeve nuk ka sjellur përmirësimin e cilësisë së shërbimit të pastrimit të qytetit dhe realizimin e objektivave të strategjike dhe pritshmërisë së qytetarëve.”

6. Mungesa e një strategjie të menaxhimit të mbetjeve nga Bashkia, ka ndikuar në menaxhimin e mbetjeve, me një infrastrukturë të dobët, me konteniere të amortizuara, të pa mbyllur, larg zbatimit të kuadrit ligjor për ndarjen në burim të mbetjeve; niveli teknik i makinerive teknologjike transport, fshirje, larje, etj., të disponueshme nga OE është i mangët.
7. Marrja e iniciativave të deritanishme për riciklim kanë qenë të pastudjuara mire, nuk kanë sjellë ndryshim të gjendjes dhe kanë dështuar duke krijuar edhe pasoja sociale.
8. Masat ndëshkuese me gjobë të marra nga Agjencia e Mbrojtjes Konsumatorëve apo nga BT, jo vetëm kanë qenë të pakta, por edhe nuk janë ekzekutuar, duke mos dhënë asnjë ndikim në përmirësimin e gjendjes.

Konkluzionet dhe rekomandimet e këtij auditimi performance, synojnë të kontribuojnë e të ndihmojnë menaxhimin e Bashkisë Tiranë, në përmirësimin e situatës dhe marrjen e masave konkrete, përgatitjen e zbatimit të një strategjie lokale për menaxhimin e mbetjeve të ngurta (si pjesë e Strategjisë Kombëtare të menaxhimit të mbetjeve), duke ndëhyrë në infrastrukturë me vendosjen e konteniervave të rinj bashkëkohorë me objektiv ndarjen në burim, rritjen e nivelit të zhvillimit të metodave të edukimit ambiental, krijimin e një partneriteti më të mire public privat me operatorët ekonomikë, krijimin e një dokumentacioni të saktë e ligjor për vlerësimin e mbikqyrjen e punës së OE, përcaktimin e grafikëve të pastrimit, shtimin e vendgrumbullimeve të reja dhe sigurimin e një mjedisi të pastër. Vendosja e kontraktimeve me subjekte private e shtetërore që prodhojnë mbetje të llojeve të ndryshme sipas metodave bashkëkohore, duke detyruar ato të paguajnë për largimin e këtyre mbetjeve sipas rregulloreve në fuqi.

Nisur nga konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar adresimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të këtij problemi social:

## **V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit Performancës, “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane në Bashkinë e Tiranës”, të ushtruar në Bashkinë e Tiranës (Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike; Drejtoria e Politikave dhe Edukimit Mjedisor, Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Aseteve, Drejtoria e Kabinetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Puntorëve nr. 1 të qytetit).

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

***A. Në drejtim të pasqyrimit të strategjisë, politikave dhe kuadrit ligjor e rregullator të menaxhimit të mbetjeve urbane në detyrimet kontraktore të operatorëve ekonomikë me Bashkinë e Tiranës.***

Të hartojë planin lokal për menaxhimin e mbetjeve si detyrim ligjor që rrjedh nga Ligji e Menaxhimit të Integruar të mbetjeve urbane, 10463 22.09 2011.

**1.** Bashkia e Tiranës të miratojë Rregulloren e re “Për Administrimin e Mbetjeve Urban dhe Pastrimit të Qytetit”, ku të përfshihen të gjitha rregullat e përgjithshme, për menaxhimin e

integruar të mbetjeve, përfshirë parandalimin ose pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i tyre, përmes pakësimit të përdorimit të burimeve dhe përmirësimit të efikasitetit të këtij përdorimi, të cilat përcaktohen në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.

***Brenda 3 muj. I-rë 2017***

2. Bashkia Tiranë të hartojë një program të plotë dhe të mirë studjuar që t’i shërbejë edukimit dhe ndërgjegjësimit të gjërë të publikut për përmirësimin e gjendjes në menaxhimin e mbetjeve urbane. Këto programe duhet të përfshijnë:

- Fushata publike përmes medias: programeve televizive dhe radiofonike, gazeta, fletpalosje, debate publike, etj.,
- Aktivitete të OJQ-ve, për edukim jo formal për menaxhimin e mbetjeve
- Projektet pilot të përfshirjes së komunitetit,
- Programe të përfshirjes së grupeve të interesit.

***Brenda 3 muj. I-rë 2017***

3. Të ngrihet grup pune dhe të institucionalizohet promovimi i edukimit të publikut, nëpërmjet bashkëpunimit me operatorët ekonomik, OJQ, dhe drejtoritë e promovimit në Bashki si për mjedisin, shëndetin dhe shërbimet publike (ndarja dhe riciklimi).

***Menjëherë***

4. Drejtoria e menaxhimit të mbetjeve të ndjekë, mbikqyrë dhe evidentojë punën e OE për plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në kontratë në drejtim të edukimit publik ambiental në çështjen e MMU si dhe të hartojë raporte vjetore ku të përfshihet edhe informacioni mbi realizimin e detyrimeve të përcaktuara për OE në drejtim të edukimit publik.

***Në vijimësi***

5. Të përmirësohet situata e menaxhimit të mbetjeve urbane nëpërmjet zbatimit të hierarkisë së mbetjeve dhe konceptit 3R (Reduktim – Ripërdorim – Riciklim), ndarja e mbetjeve që në burim, gjë që do të lehtësonte dhe ulte kostot e riciklimit, si dhe rriste përqindjen e mbetjeve që shkojnë për riciklim.

***Në vijimësi***

6. Bashkia e Tiranës të rrisë bashkëpunimin me shoqatat dhe organizatat mjedisore, jo fitimprurëse për të arritur drejt një informimi sa më të mirë të publikut për të mirat që sjell ndarja e mbetjeve në burim.

***Në vijimësi***

7. Në bashkëpunim me OJF-të mjedisore, grupet e interesit dhe bazuar në SKM (Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve) përfshirë banoret, minibashkitë dhe qeverinë qendrore me nismën e saj BT, të organizojë aktivitete, si dhe të shfrytëzojë mediat e mjetet e tjera të komunikimit për ndërgjegjësimin, pjesëmarrjen dhe promovimin e veprimtarive demonstruese e ndërgjegjësuese të projekteve pilot në shkollë dhe komunitet në drejtim të mirëmenaxhimit të mbetjeve dhe rolit të tij në përmirësimin e cilësisë së jetës.

***Në vijimësi***

8. Bashkia e Tiranës të krijojë një website për MMU (menaxhimin e mbetjeve urbane), i cili të

përmirësohet dhe të jetë operacional, në mënyrë që të përcjellë mesazhet e nevojshme të sa më shumë njerëz, ku të gjejnë vend edhe praktikantët e mira të vendeve të zhvilluara të tilla si fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe mjetet e përdorura për menaxhimin me efektivitet të mbetjeve urbane.

***Menjëherë***

9. Bashkia e Tiranës të kërkojë pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Arsimit e Sporteve, diskutimin dhe përfshirjen e edukimit mjedisor në kurrikulat mësimore, ku përveç teksteve të përfshihen edhe programet video si një nga mjetet me të suksesshme të edukimit në shkollë, programe vizitash në terren për grumbullimin e mbetjeve, trajtimin e ndërmjetëm, depozitimin e mbetjeve dhe industrite e riciklimit.

***Menjëherë***

***B. Në drejtim të arritjes së objektivave të parashikuara nga Bashkia e Tiranës në grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane nga operatorët ekonomikë privatë.***

10. Bashkia e Tiranës të marrë masa të menjëhershme, për të bërë bilancin e sasisë së përgjithshme të mbetjeve urbane që gjenerohen brenda territorit të Tiranës, duke i ndarë ato në mbetje familjare, mbetje të gjeneruara nga personat fizikë dhe juridikë, shtetërorë dhe privatë.

***Menjëherë***

Bashkia e Tiranës të marrë masa të menjëhershme, për të detyruar të gjithë subjektet private të sistemojnë mbetjet e tyre në kontenerët përkatës apo të veçantë dhe jo në ato familjare

***Menjëherë***

11. Bashkia Tiranë të evidentojë subjektet që janë objekt i lejes mjedisore, të cilat gjenerojnë mbetje jo thjesht apo vetëm urbane, por që kryejnë aktivitetin e tyre brenda territorit të Bashkisë. Gjithashtu të evidentohen të gjitha subjektet që gjenerojnë mbetje dhe nëse në këto mbetje ka përbërës të rrezikshëm. Për subjektet që gjenerojnë mbetje të rrezikshme të evidentohet edhe mënyra e grumbullimit, transportit, depozitimit dhe trajtimit deri në asgjësimin përfundimtar të tyre, duke krijuar kontrata tip me këto subjekte mes tyre, pra subjekti prodhues i mbetjeve - Bashkisë Tiranë - Operatorit ekonomik që e mbulon zonën e vendndodhjes së subjektit, kjo kundrejt tarifës së caktuar nga Bashkia Tiranë. Kjo me blu nuk duhet vënë, sepse e realizon apo e kërkon leja mjedisore

***Brenda 3 muj. I-rë 2017***

12. Bashkia Tiranë të marrë masa dhe në bashkëpunim e mirëkuptim me OE të gjejë forma të tjera dhe të përshtatshme të pastrimit të rrugëve (duke zëvendësuar pastrimin me fshesë dore me makineri thithëse), për kontratat ekzistuese dhe ta përfshijë si klauzolë detyruese në kontratat e ardhshme,

***Brenda 3 muj. I-rë 2017***

13. Nëpërmjet një studimi dhe analize konkrete të gjendjes së krijimit dhe depozitimit të mbeturinave urbane, duke marrë parasysh gjendjen aktuale, densitetin e banorëve, vendet e kontenerëve dhe distancën aktuale nga përdoruesit, të përcaktohet numri i nevojshëm i kontenerëve të mbetjeve dhe vendndodhja e kontenerëve të mbetjeve të përshtatshëm për

përdoruesit sidhe të merren masat për eliminimin e venddepozitimeve të paligjshme të mbetjeve.

***Në vijimësi***

**14.** Bashkia Tiranë të realizojë studimin e fisibilitetit, (vlerësimin e riskut dhe analizën kosto përfitim për të gjithë procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve), duke llogaritur koston e projektit, për të bërë të mundur zgjedhjen e metodës me leverdisshmëri ekonomike duke respektuar njëkohsisht normat dhe standardet social-mjedisore. krijimin e një landfilli të ri me parametra bashkëkohorë dhe fillimin e procedurave të nevojshme, për garantimin e këtij procesi, sipas detyrimeve që parashikon ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Hiq blu

***Brenda 3 muj. I-rë 2017***

**15.** Bashkia Tiranë, të ndërmarrë masat e nevojshme për venien në punë të impiantit të biogazit në venddepozitim të Sharrës, masë kjo që do të ndikojë në pakësimin në minimum të lëshimit të erërave të këqija, ngacmuese dhe të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin e popullsisë së zonës dhe të qytetit.

***Brenda 3 muj. I-rë 2017***

**16.** Nga Bashkia Tiranë të ndërmerren veprimet institucionale me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, për sigurimin e fondeve për financimin të ndërtimit të impiantit të pastrimit të ujërave, për të eliminuar ujërat e ndotura (shllamit) që dalin si rezultat i mbetjeve urbane dhe derdhen në Lumin Erzen, duke rrezikuar shëndetin e komunitetit dhe ndotur mjedisin.

***Në vijimësi***

Nga Bashkia Tiranë të ndërmerren veprimet institucionale me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, për sigurimin e fondeve për financimin e rehabilitimit dhe kujdesit pas mbylljes të venddepozitës aktuale të Sharrës..

***Në vijimësi***

**17.** Drejtoria e Përgjithshme nr. 1 e Puntorëve të Qytetit, të programojë dhe të realizojë monitorimin e shllamit, duke u bazuar në një test karakteristikash për substancat aromatike, volatile, halikarbonet dhe ndotësit organik me natyrë bazike, acide apo neutrale që mund të jenë të pranishëm në venddepozitim të Sharrës; pikat e vëzhguara gjatë monitorimit për sa i përket ujërave sipërfaqësorë, të përcaktohen si në rrjedhat e sipërme ashtu dhe në rrjedhat e poshtme të derdhjes ujore.

***Në vijimësi***

**18.** Bashkia Tiranë të kryejë çdo muaj analizat e cilësisë së ajrit në drejtim të krahasimit të sistemit mbajtës të gazeve në venddepozitim të Sharrës, me normat sipas standardeve të cilësisë së ajrit i cili nuk duhet të tejkalojë:

- Maksimumi i përqëndrimit për NO<sub>2</sub> – 320 mg/m<sup>3</sup>
- Mesatarja vjetore e përqëndrimit për NO<sub>2</sub> – 103 mg/m<sup>3</sup>.

***Çdo muaj***

**19.** Bashkia e Tiranës të publikojë në çdo rast raportin e monitorimit të elementëve të cilësisë së ajrit, ujit e tokës, që rezultojnë nga matjet e tjera të kryera në venddepozitim të Sharrës.

***Çdo tre muaj***

**20.** Bashkia e Tiranës të ndajë në burim me anë të konteneri specifik mbetjet familiare të rrezikshme.

**E vazhdueshme**

21. Bashkia e Tiranës të aplikojë masat administrative për kundravajtjet përkatëse duke ndëshkuar me gjobë çdokënd që nuk respekton ndarjen në burim të mbetjeve.

**E vazhdueshme**

22. Bashkia e Tiranës të aplikojë masat për sistemimin e mbetjeve organike ose të kontenierit me mbetje të njoma në parcelat të vecanta për kompostim pranë landfillit.

**E vazhdueshme**

23. Bashkia e Tiranës të aplikojë masat për rindarjen e mbetjeve të thata në një pikë transferimi pranë landfillit, duke siguruar lëndë të parë dytësore për kompanitë e riciklimit.

**E vazhdueshme**

24. Bashkia e Tiranës të nxisë dhe stimulojë të gjithë qytetarët e Tiranës duke aplikuar masa për ngritjen e njësisive të shërbimit për marrjen e mbetjeve me bazë riciklimi, kundrejt një tarife të llogaritur.

**E vazhdueshme**

25. Bashkia e Tiranës për çdo lloj vendimmarrje në përzgjedhjen e metodave për menaxhimin e mbetjeve urbane duhet ta realizojë në bashkëpunim me komunitetin dhe qytetarët.

**E vazhdueshme**

26. Bashkia Tiranë, të marrë masa dhe të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm ligjor e administrativ për mbikqyrjen e shërbimit të pastrimit, duke hartuar një proces verbal tip, me numer serial duke përshkruar formën dhe përmbajtjen sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Administrative, ku të vendoset qartë emri i operatorit dhe të lihet vend i shprehjes së miratimit apo kundërshtimit prej operatorit.

***Menjëherë***

27. Bashkia Tiranë, të marrë masa për plotësimin e pasqyrës së llogaritjeve sipas kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar e Kontrollin” dhe Udhëzimin nr 30 datë 17.12.2011, ku të përcaktohen të gjithë zërat me njësi: volumi, çmimi e vlera, dhe të përcaktohet qartë vend i konstatimit të parregullsisë në kryerjen e shërbimit të pastrimit, etj.

***Menjëherë***

28. Bashkia Tiranë, të hartojë një format tip situacioni, ku në kolonat përkatëse të shprehet qartë llogaritja dhe kryerja e ndalesës në vlerë dhe jo në volume, kjo në përmbushje të kërkesave të sanksioneve ligjore të paraqitura në kontratën e shërbimit.

***Menjëherë***

29. Bashkia Tiranë, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës së menaxhimit të mbetjeve, Drejtorisë së Financës dhe Drejtorinë Juridike, për hartimin e një metodologjie tip për mbikqyrjen e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe hartimit të dokumentacionit tekniko ligjor të pasqyrimit të shkeljeve të kontratës dhe llogaritjes së efekteve financiare.

***Brenda 3 muj. I-rë 2017***

30. Bashkia Tiranë të ngrejë një grup pune, i cili të marrë në analizë punën e mbikqyrësve të shërbimit të pastrimit, duke vlerësuar performancën e tyre dhe ligjshmërinë e veprimtarisë së tyre, mbështetur në treguesit konkretë të punës dhe nxjerrjen e përgjegjësitë dhe të detyrave për përmirësimin e punës në të ardhmen.

*Brenda 3 muj. I-rë 2017*

31. Bashkia Tiranë, për nevoja të plotësimit të detyrës së mbikqyrjes së procesit pastrimit të mbetjeve të ngurta, të marrë masa dhe të pajisë mbikqyrësit me pajisje të tilla si aparat fotografik, etj. të nevojshme për dokumentimin e punës së operatorëve ekonomikë.

*Menjëherë*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**